

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	---	---

Në bazë të nenit 77, paragrafi 2, nenit 80 paragrafi 1, 2 dhe 3 dhe nenit 81 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Shtojcës Nr. 9 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik si dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT-Nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Prishtinës shpallë :

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

DREJTORIA E MIRËQENIES SOCIALE

POZITA: Ndhmës Infermier/e në Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa përkujdesje Familjare – Tre (3) Ekzekutues

KOEICIENTI SIPAS LIGJIT TË PAGAVE: 4.5

KLASA: H21

ORARI I PUNËS: 40 orë në javë

MBIKQYRËSI: Udhëheqësi i SHPMPPF-së

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Bën pastrimin e përgjithshëm të klientëve të varur dhe gjysmë të varur;
- Bën ndërrimin e ndërresave të shtratit dhe rregullimin e shtratit të rezidentëve;
- Ushqen rezidentet e varur dhe gjysmë të varur;
- Bashkëpunon me motra dhe teknik medicinal dhe ndihmon në internimet tekniko medicinale;
- Kujdeset dhe është përgjegjëse për pastërtinë e dhomave dhe ambientit ku jetojnë rezidentët;
- Ndërresat e pa pastërta të rezidentëve i bart në lavanderi, dhe të pasta i merr nga lavanderia;
- Bën përgatitjen e rezidentit të vdekur me prezencën e motrës apo teknikut medicinal;
- Është përgjegjëse për inventarin në repart dhe mjetet tjera të besuara.

Kushtet e Aplikimit:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Prishtinës);
- Dokument identifikimi kopje (Letërnjoftim ose Pasaportë Valide të Republikës së Kosovës);
- Diplomat e Shkollës së Mesme të Lartë;
Përvoja e punës nuk kërkohet mirëpo kandidatët inkurajohen të sjellin dëshmi të përvojës së paraprake të punës nëse kanë;
- Dëshmi të trajnimeve profesionale të ndjekura nëse kanë;
- Diplomat e noterizuara, Certifikata mjekësore dhe Çertifikata mbi dënimet penale (të shkarkohen nga platforma E-kosova) duhet të sillen me rastin nënshkrimit të kontratës;

Data e shpalljes së Konkursit :15.09.2025 deri me dt. 14.10.2025

- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Objektin e Vjetër të Komunës së Prishtinës.
- Në aplikacion duhet te ceket qartë titulli i vendit te punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet te jenë kopje dhe nuk kthehen.
- Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu si parashihet me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.
- Vetëm kandidatët që kalojnë Procedurën e Verifikimit Paraprak do i nënshtrohen Testimit me Shkrim.
- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e shpalljes për pozitën e cekur më lart.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni me Sektorin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, ne nr. të tel. 038- 230-900, lok.10-70.